

<b>Shtallë e pulavepulave, Tipi i lirë në Shushicë</b>  <b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova Republic of Kosova	<b>DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS</b>		 <b>Komuna e Istogut</b> Opstina Istog Municipality of Istog
	Nr. 11-351-02/21	Dt. 18.01.2021	

Duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikimit Hapësinor, Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110 neni 18, Ligji për mbrojtjen e tokës bujqësore 02/L-26 neni 11. Pika 1 dhe Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03 neni 21,22,44 dhe 84 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), neni 17 pika d/, të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit administrativ të MMPH - së nr. 06/2017 të dt 23.05.2017 për shqyrtimin e kërkesës për Kushtet e ndërtimit dhe Lejës së ndërtimit si dhe duke vendosur sipas kërkesës me nr. 11-351-1390 të datës 12.01.2021, investitor Leonora Ademaj, për lëshimin e Lejës ndërtimore me karakter të përhershëm për **Ndërtimin e ndërtesës– Fermë e pulave - Tipi i lirë në Shushicë**, Drejtorja për Planifikim Urban dhe Mjedis, në procedurë administrative, merr këtë:

## VENDIM

### LEJE NDËRTIMI – SHTALLË E PULAVE NË SHUSHICË

<b>Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:</b>			
Emri:	investitor Leonora Ademaj, Shushicë		
Adresa:	rr. ‘Rexhep Ademi’ në Shushicë		
Telefoni:		Emaili:	

Emri i Projektit:	e Lejës ndërtimore me karakter të përhershëm për <b>Ndërtimin i ndërtesës – Shtallë e pulave - Tipi i lirë në Shushicë</b>		
Emri i Projektuesve:	1. Arkitektura - Xhafer Isufi m.sc. ark. & Faton Blakaj ark. 2. Gjeodezia – Halit Kabashi ing.dip. geo.		
Co. projektuese:	Studio projektuese “Arch-ART”, rr. “Ibrahim Rugova” nr.115 në Istog		
Telefoni:		Emaili:	

**Për punët ndërtimore në vijim:**

- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
  - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike;
  - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
  - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

## A r s y e t i m

Aplikuesi - investitor Leonora Ademaj me kërkesë për Leje ndërtimi me nr. 11-351-1390 të datës 12.01.2021 ka kërkuar nga DPUM, lëshimin e Lejes ndërtimore për **Ndërtimin e ndërtesës – Shtallë e pulavepulave - Tipi i lirë** në Shushicë, në lokacionin e përshkruar në paragrafin 1. të dispozitivit të vendimit të lejës ndërtimore.

DPUM pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të kërkesës baxë, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr. 5/L-031 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për **lëshimin e Lejes Ndërtimore**, andaj u vendos si në dispozitiv.

### Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Dëshmi të pronësisë dhe dokumentacioni personal i fotokopjuar
- Kushtet Ndërtimore (është paisur-fotokopje)
- VNM – Pelqimi komunal
- Tri kopje të projektit ideor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e I-rë
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave
- Te tjera – nuk ka

**Shtojcë:** Situacioni i kompleksit me pozicionim të objektit, dispozita urbanistike e pozicionimit të objektit me kordinata, në sistemin koordinativ KOSOVAREF01.

**Udhëzim juridik:** Pala e pa knaqur me këtë vendim, përmes kësaj drejtorie, me ankesë mund ti drejtohet MMPH në Prishtinë brenda afatit prej 30 ditësh. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të do të përcillet te organi epror – MMPH.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, kësaj Drejtorie, Drejtorisë për inspektim, Drejtorisë së kadastrit, Drejtorisë së financave, Qendrës për shërbime me qytetar.

**DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS NË ISTOGUT,**

Zyrtar për urbanizem  
ark. Rustem Gashi

Udh. Sek. Urbanist,  
ark. Rexhep Blakaj id

DREJTOR,  
Jashar Blakaj idn